



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Pr.Nr. 1928/2023
Nr.i fo/Br.str./Nr.pg. 12/12/2023
Data/Datum/Date: 12/12/2023

PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 12 dhjetor 2023

Z. Elvir Azizi, drejtor i përgjithshëm
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Rr. "Lagja e Spitalit" p.n.
10 000 Prishtinë

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr.671/2022

I nderuari z. Azizi,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, e ka pranuar ankesën e parashtruar nga M. A. (me tutje: ankuesi), parashtruar kundër Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK), për shkak të mospërgjigjes në ankesën e parashtruar më 28 tetor 2022.

Sipas pohimeve të ankuesit dhe shkresave të lëndës kuptohet se ai, më 7 tetor 2022, kishte realizuar një vizitë mjekësore me fëmijën e vet (2 muajsh) në Kliniken e Pediatrisë, por në dalje të ShSKUK-së ishte detyruar ta kryente pagesën për shfrytëzimin e parkingut të ShSKUK për veturn me të cilën e kishte dërguar fëmijën në klinikë, edhe pse ai kishte thënë se inkasantit (te rampa në dalje) ia kishte prezantuar raportin për vizitën e fëmijës te mjeku.

Më tutje ankuesi kishte thënë se më 28 tetor 2022, nëpërmjet postës elektronike kishte parashtruar ankesë në drejtorin e ShSKUK-së dhe kishte ngritur shqetësimet e tij për pamundësinë e daljes nga oborri i ShSKUK-së pa e kryer pagesën për parking, edhe pse kishte raport mjekësor për vizitën e realizuar për fëmijën 2 muajsh në Kliniken e Pediatrisë. Gjithashtu ankuesi kishte ngritur shqetësimë se një veprim i tillë përbënte shkelje të së drejtës se fëmijës së tij për të pasur qasje të plotë në shërbime shëndetësore. Sipas pohimit të ankuesit, deri në paraqitjen e ankesës në IAP, nuk kishte marrë përgjigje nga ShSKUK-ja.

Lidhur me këtë, më 20 shkurt dhe më 15 maj 2023, zyra e Avokatit të Popullit, nëpërmjet postës elektronike kishte kërkuar informata nga drejtoria e ShSKUK-së, për veprimet që janë ndërmarrë apo që planifikoheshin të ndërmerrreshin nga ShSKUK-ja, në mënyrë që ankuesit t'i jepej përgjigje në ankesën tij të datës 28 tetor 2022. Më 15 maj 2023, përfaqësuesi i drejtorisë së ShSKUK-së e kishte njoftuar zyrën e Avokatit të Popullit se jo të gjithë fëmijët janë të liruar nga pagesa për parking, janë të liruar vetëm fëmijët që janë diagnostikuar me diagnoza që lirohen sipas rregullores.

Edhe pse ankesa e ankuesit te Avokati i Popullit ishte parashtruar për mospërgjigje në ankesë e tij, Avokati i Popullit, nga përgjigja e drejtorisë së ShSKUK-së kishte kuptuar se Rregullorja Nr. 116 për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e ShSKUK-së/QKUK-së (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja) kishte liruar nga pagesa e parkingut një kategori të personave

që shfrytëzojnë parkingun në hapësirat e ShSKUK-së, e këtu sipas përgjigjes hyjnë edhe fëmijët e diagnostikuar me diagnoza të caktuara, por jo të gjithë fëmijët që kërkojnë shërbime shëndetësore në QKUK.

Avokati i Popullit e ka analizuar rregulloren në fjalë, e cila është akt normativo-juridik, i nxjerrë nga Bordi Drejtues i ShSKUK-së, duke u mbështetur në statutin e ShSKUK-së dhe në Ligjin nr. 04/L-125 për Shëndetësi. Rregullorja në nenin 1 ka përcaktuar kushtet, kriteret, procedurat e shfrytëzimit të parkingut në hapësirat e ShSKUK-së me qëllim të shfrytëzimit sa më racional të parkingut dhe lehtësimin e qasjes te klinikat apo shërbimet nga pacientët të cilët kanë nevojë për shërbime shëndetësore. Përcaktimi i kritereve për shfrytëzim të parkingut nuk ka për qëllim përfitimin material. Tuttje, në nenin 7 të së njëjtës rregullore, përcaktohen kategoritë që lirohen nga pagesa e parkingut, ku mes të tjerësh janë liruar pacientët e diagnostikuar me kancer, ata në dializë dhe me diabet tip 1.

Në përgjigen e drejtorisë së ShSKUK-së thuhej se janë të liruar vetëm fëmijët që janë diagnostikuar me diagnoza që lirohen sipas rregullores, por jo të gjithë fëmijët që kërkojnë shërbime shëndetësore në QKUK.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit vlerëson se për t'u konsideruar qasja e plotë në shërbime shëndetësore për fëmijët, duhet të jetë edhe qasja e lehtë për prindërit në institucionë shëndetësore, pa bariera të tillë, siç është rasti me pagesën e parkingut brenda hapësirës së ShSKUK-së. Për më tepër, qasja e lehtë për prindërit në institucionë shëndetësore për të marrë shërbime shëndetësore për fëmijët kontribuon edhe në marrjen e shërbimeve më efikase për fëmijët. Kujdesi për shëndetin e fëmijëve përfshin, përveç të tjerash, edhe vizitat e rregulla mjekësore, të cilat njëherësh kontribuojnë në parandalim dhe diagnostikim të ndonjë sëmundje eventuale.

Avokati i Popullit rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton shprehimisht të drejtat e fëmijëve dhe imponon detyrime ligjore për shtetin për t'i respektuar, mbrojtur dhe përbushur këto të drejta (neni 50).

Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e cila është pjesë përbërëse e Kushtetutës se vendit, në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: “*Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucionë publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykata, autoritetet administrative apo organet legislative, interesit më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.*” Tutje Konventa thotë se shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar një gjendje shëndetësore sa më të mirë [...] (neni 42). Tutje Konventa thotë se shtetet palë përpiken të sigurojnë që asnjë fëmije të mos i mohohet e drejta për t'i pasur këto shërbime të kujdesit shëndetësor.

Rrjedhimisht për realizimin e kësaj të drejte, autoritete shtetërore përgjegjëse duhet t'i ndërmarrin masat e duhura për t'ua siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore dhe kujdesin për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor.

Edhe Ligji nr. 06/l-084 për Mbrojtjen e Fëmijës ka për qellim, pos të tjerash: “*Garantimin e mirëgenies dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, ndihmën dhe përkujdesjen efektive për fëmijën, shëndeti dhe mirëgenia e të cilit janë në rrezik.*”

Për më tepër, ky ligj përcakton se të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo nga kujdestari, nga institucionet, nga shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, nga profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, nga gjykatat, nga autoritetet administrative apo nga organet legislative, interesit më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta. Tuti ky ligj, në nenin 42, ka përcaktuar: “*Fëmijës i garantohej e drejta për kujdes shëndetësor falas, përfitimi nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit me standard të lartë.*” Për më tepër, garantimi i kësaj të drejte bëhet nga ministria përgjegjëse për shëndetësi, e cila merr masa, pos të tjerash, edhe për t’ia siguruar fëmijës kujdesin shëndetësor falas e cilësor, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor.

Avokati i Popullit, pas analizës ligjore të Rregullores Nr. 116 për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK-së/ShSKUK-së, në relacion me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe me rishikimin e dokumentacionit të çështjes, të informatave të paraqitura nga institucioni përkatës, konstaton se në rastin konkret *ka shkelje të të drejtave të fëmijëve për qasje të plotë dhe falas në shërbime shëndetësore*, për faktin se me rregulloren në fjalë është vënë barrierë për të marrë fëmija shërbime të plota shëndetësore falas sipas ligjit, ngase prindërvë u duhet ta paguajnë parkingun në hapësirat e QKUK-së/ShSKUK-së. Rrjedhimisht del se shërbimet shëndetësore përfëmijë nuk janë falas.

Në drejtim të kësaj, Avokati i Popullit vlerëson se nenii 7 i Rregullores Nr. 116 për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK-së/ShSKUK-së është në kundërshtim me frymën e dispozitave të lartçekura të Kushtetutës, të Konventës dhe të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Gjithashtu, nga hetimi i ankesës, Avokati i Popullit ka vërejtur se rregullorja në fjalë, në bazë të së cilës qytetarët janë të obliguar t’i kryejnë pagesat, nuk është e publikuar në faqen zyrtare të ShSKUK-së, ashtu siç e përcakton nenii 5 i Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.¹

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit vlerëson se rregullorja në fjalë është akt i përgjithshëm juridik, që i prek interesat e qytetarëve, dhe mospublikimi i saj ua pamundëson qytetarëve që të njoftohen përfshirë përmbytjen e saj, përkatësisht me çmimin dhe me kategoritë që janë të liruara nga pagesa.

Prandaj Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës:

- Ta plotësojë/ndryshojë Rregulloren Nr. 116 për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK-së/ShSKUK-së, përkatësisht në nenin 7 të përfshihet edhe kategoria e fëmijëve që lirohen nga pagesa e parkingut në hapësirat e QKUK-së/ShSKUK-së.

¹ Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Kapitulli II [Publikimi i Dokumenteve Publike], nenii 5 [Publikimi me iniciativë të institucioneve publike].

- Ta publikojë në faqen zyrtare elektronike të saj, Rregulloren Nr. 116 për Shfrytëzimin e Parkingut në Hapësirat e QKUK-së/ShSKUK-së.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.*”) dhe me nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjiga duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.*”), ju lutemi mirësish të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

